



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL

PS.nr.15/23

Datë 20.09.2023

FTESE PËR SEANCE


FTOHET i akuzuari **Çedomir Aksiç**, i lindur me datë 10.05.1960, i biri i Vojmir, me vendbanim në Naupare-Krushevac, Serbi, me numër personal 1005960960098, të marrë pjesë në seance fillestare të caktuar me datë **20.11.2023, e hëne, në ora 09:00**, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, për çështjen penale të proceduar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, **PPS. nr.62/19, të datës 04.05.2023**, për shkak të veprës penale Krimet e Luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 të Ligjit Penal të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e inkriminuar si Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventës së të Gjenevës, dhe neni 4 të protokollit 2 të datës 08.06.1977, aktualisht e ndëshkuar me nenin 146 dhe 147 të Kodit nr.06/L-079, Penal të Republikës së Kosovës.

Konform nenit 303 par 8. të KPPRK-së, gjykata i bërë thirrje të të akuzuarit **Çedomir Aksiç**, të dorëzohet dhe të paraqitet sa më parë pranë kësaj gjykate, që kjo çështje penale të zhvillohet me prezencën e tij në seancën e caktuar me datë dhe në kohë si më lartë.

Konform nenit 303 par 8. të KPPRK-së, gjykata i bërë thirrje çdo personi që ka informacion relevant për vendndodhjen e të akuzuarit **Çedomir Aksiç**, që t'ia komunikojë atë informacion policisë, me qëllim të sigurimi të prezencës së akuzuarit **Çedomir Aksiç**, në këtë çështje penale.

Bashkangjitur: Aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, **PPS. nr.62/19, të datës 04.05.2023**, kundër të akuzuarit **Çedomir Aksiç**, për shkak të veprës penale si më lartë.

Kryetarja e trupit gjykues- gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Speciale / Specijalno Tužilaštvo / Special Prosecution
Departamenti për Krim të Organizuar / Odeljenje za Organizovani Kriminal /
Department for Organized Crime



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

PPS nr. 62/2019
Datë: 02.05.2023
PRISHTINË

GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË
- Departamentit Special -

Në bazë të nenit 234 par. 1 dhe 2, nenit 235 par. 1 të KPP-së lidhur me nenin 303 par 7 dhe nenin 346/ A për gjykim në mungesë të Ligjit numër 06/L-091 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale NR. 04/l-123, Ligjit nr. 08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit 06/L-091, paraqes këtë:

AKTAKUZË
PËR GJYKIM NË MUNGESË

Palë e pandehur:

Emri	Čedomir
Mbiemri	Aksić
Gjinia	Mashkull
Emri i babës	Vojimir
Mbiemri i babës	Aksić
Emri i nënës	
Mbiemri i nënës	
Mbiemri i vajzërisë së nënës	
Vendlindja	Petrovë-Shtime
Datëlindja	10.05.1960
Nr. Personal	1005960960098
Statusi civil	Martuar

2020:0005588



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

Shkrim dhe lexim	
Përgatitja profesionale - Niveli i arsimit	
Të ardhurat personale ose të ardhurat tjera	
Adresa (Komuna, Vendbanimi, Rruga)	Naupare -Krushevac, Republika e Serbisë
Masa e ndalimit	Jo

Për veprat penale:

Personi	Čedomir Aksić
Ka kryer veprën penale	Krimi i luftës kundër popullsisë civile, e ndëshkuar me nenin 142 të Ligjit Penal të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tutje "RSFJ") si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht i ndëshkueshëm sipas veprës penale Krime lufte në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët për konventat e Gjenevës, dhe nenin 4 të Protokolit 2 të datës 08.06.1977, aktualisht e ndëshkueshme me neni 146 dhe 147 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje "KPRK");

S E P S E

U vërtetua dyshimi i bazuar mirë, se i akuzuari Čedomir (Voimir) Aksić, në periudhën kohore prej muajit janar-maj 1999, duke bashkëvepruar me një grup njerëzish kriminal (tani për tani të pa identifikuar), të organizuar, të veshur me uniforma policore, paramilitare, ushtarake ka shkaktuar vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose të shëndetit, frikësimit, ndaj popullatës së pambrojtur civile, vrasje, urdhërimi për zhvendosjen e popullatës civile për shkaqe që lidhen me konfliktin dhe luftën, drejtuar me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt apo luftë, ashtu që gjatë konfliktit me karakter jo-ndërkombëtar të zhvilluar në mes të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave Ushtarake të Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) dhe forcave policore të Serbisë, me dashje i shkel rregullat e së drejtës



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

ndërkombëtare kundër personave civil, konkretisht nenin 3 paragrafi 1 pika (a) të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe neni 4 paragrafi 2, pika (a) të Protokollit II, në atë mënyrë që :

Në fillim të muajit prill të vitit 1999, i akuzuari Čedomir (Voimir) Aksić, duke bashkëvepruar me një grup njerëzish kriminal (tani për tani të pa identifikuar), në pikën "Kodra e Gështenjave", e cila gjendet në pjesën në mes Shtimes dhe fshatrave Mulapolc, Reçak dhe Petrovë, fillimisht i akuzuari me pjesëtar të tjerë të forcave serbe, kishin urdhëruar dëbimin e të gjithë banorëve të lagjes, pas depërtimit me dhunë të popullatës civile i akuzuari së bashku me pjesëtar të tjerë të forcave serbe ka marrë pjesë në ekzekutimin dhe djegien e shtëpive të të dëmtuarve vëllezërve, Ruzhdi Jashari, Sadri Jashari, Rexhep Jashari dhe Hamdi Jashari në rrugën "Sylejma Vokshi" pn, në Shtime, me çka të dëmtareve ju ka shkaktuar dëm moral dhe dëm materiale në shumën prej 300.000 euro,-

I akuzuari Čedomir Aksić me datën 13 - 14 maj 1999, në vendin e quajtur "Lugu i Neshës", në fshatin Pertovë të Shtimes, duke bashkëvepruar me një grup njerëzish kriminal (tani për tani të pa identifikuar), të organizuar, të veshur me uniforma policore, paramilitare, ushtarake ka shkaktuar vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose të shëndetit, frikësimi, ndaj popullatës së pambrojtur civile, vrasje, urdhërimi për zhvendosjen e popullatës civile për shkaqe që lidhen me konfliktin dhe luftën, drejtuar me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt apo luftë, ashtu që derisa i ndjeri Halil Hysenaj, kishte qenë së bashku me familjen e tij dhe me pjesëtar të tjerë të popullatës shqiptare të fshatit Pertovë të Shtimes, duke qëndruar në mal për tu mbrojtur nga sulmet që kishin filluar nga forcave serbe, në momentin kur forcat serbe kishin filluar të shkojnë në drejtim të vend qëndrimit të dëmtuarve në mal, tani i ndjeri me qëllim që të sigurohet se a janë pjesëtare të UÇK-së apo forcat serbe, ishte nisur në drejtim të tyre, por ishte ndaluar nga vet i akuzuari Čedomir Aksić, i cili kishte qenë i veshur me uniforma lara - lara, e që tani të ndjerin Halil Hysenaj e kishte mbështetur për një "stami" dhe ia kishte drejtuar armën pushkën 10-she, ndërsa me vonë Halil Hysenaj, është gjetur nga fshatarët pa shenja jete, me ç`rast familjes së tij i është shkaktuar vuajtje të mëdha shpirtërore dhe dëm material dhe moral,-

I akuzuari Čedomir Aksić, me datën 15 janar 1999 në fshatin Reçak, të Komunës së Shtimes, duke bashkëvepruar me një grup njerëzish kriminal (tani për tani të pa identifikuar), grup ky i organizuar, i veshur me uniforma policore, paramilitare, ushtarake, ka shkaktuar vuajtjeve të mëdha apo cenim të integritetit trupor ose të shëndetit, frikësimi, ndaj popullatës së pambrojtur civile, vrasje, urdhërimi për zhvendosjen e popullatës civile për shkaqe që lidhen me konfliktin dhe luftën, drejtuar me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt apo luftë, ashtu që ka marrë pjesë në vrasjen Hajriz Brahimi, Hakin Murati, Sabri Murati, dhe Arif Murati, Ahmet Mustafes, Sadik Mujotes, Skënderit Halilit dhe Haumshahe Mujota, në atë mënyrë që deri sa kishin filluar sulmet



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

e armatosura në drejtim të popullatës shqiptare civile dhe derisa i moshuari Hajriz Brahimi (tashmë i ndjeri) kishte filluar të largohet nga shtëpia e tij dhe po shkonte në drejtim të malit, papritmas i akuzuari me grupin e tij, ka shtënë me armë zjarri në drejtim të tij dhe është goditur menjëherë, ashtu që pas disa sekondash Hajriz Brahimi (tani i ndjeri) ka rënë për toke i vdekur, pastaj i akuzuari Čedomir Aksić, së bashku policët e tjerë pas 10-15 min janë afruar afër Hajrizit Brahimi që ishte i shtrirë dhe e godasin prapë me armë me qëllim që të sigurohen që ka vdekur, pas disa çastesh përsëri i akuzuari së bashku me personat e njëjtë, ka shtënë në drejtim të të moshuarëve vëllezërve Hakin Murati, Sabri Murati, dhe Arif Murati, ashtu që derisa të moshuarit vëllezërit Haki Murati, Sabri Murati dhe Arif Murati, që ishin duke u larguar nga shtëpitë e tyre në drejtim të malit, kaluan një përroçke, i akuzuari me grupin e tij në ato momente ka shtënë me armë edhe në drejtim të tyre dhe tre personat e moshuar kanë mbetur të vrarë në vend, pastaj i akuzuari së bashku me pjesëtarët e tjerë të uniformuar pas disa minutave, ishin afruar afër vëllezërit Murati, që ishin të shtrirë dhe i ka goditur përsëri me plumba edhe për së afërmi, ndërsa ky i akuzuar me të njëjtin grup kanë zbritur poshtë fshatit në shtëpinë e Ahmet Mustafes, duke thyer derën me forcë dhe duke nxjerr Ahmetin, gruan e tij Salën dhe Mentor Halilin nga shtëpia e tyre, pak minuta më vonë të njëjtit në prezencën e të bashkëshortes Sala dhe Mentorit vranë Ahmet Mustafën, kapën Mentorin dhe e shtynin herë të njëri herë tek tjetri person, por Mentori disi kishte arritur të largohet nëpër breshëri plumbash dhe ka shpëtuar, pas disa minutash përsëri të njëjtit derisa po kontrollonin shtëpitë në fshat, ka shtënë me armë në drejtim të Sadik Mujotes, i cili ishte duke kaluar rrethojën e oborrit me qëllim që të largohet nga aty ku ishin forcat serbe, kështu që duke u larguar nga aty është goditur nga plumbat dhe ka mbetur i vrarë në vend, pastaj kanë shtënë në drejtim të Skënder Halilit, të cilin e plagosën në këmbë dhe ka mbetur i shtrirë për tokë, meqenëse Sadik Mujota kishte mbetur i vrarë, vajza e tij Haumshahe Mujota, nëpër breshëri plumba kishte shkuar t'i ndihmoj babait të saj Sadikut, por nga të njëjtit persona është goditur me armë dhe ka mbetur e vrarë afër kufomës së babait të sajë, ndërsa i akuzuari me pjesëtarët e tjerë janë ofruar tek Skenderi Halili, që kishte mbetur i plagosur dhe e kanë goditur me armë përsëri me qëllim që të sigurohen se ka vdekur, po ashtu të njëjtit nga aty kanë shtënë dhe kanë vrarë edhe Mehmet Mustafën në oborr të shtëpisë, me ç'rast familjareve të këtyre viktimave i kanë shkaktuar vuajtje të mëdha shpirtërore, dëm moral dhe material,-

Me këtë i akuzuari ka kryer veprën penale Krim i luftës kundër popullsisë civile, e ndëshkuar me nenin 142 të Ligjit Penal të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tutje "RSFJ") si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht i ndëshkueshëm sipas veprës penale Krime lufte në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët për konventat e Gjenevës, dhe nenin 4 të Protokolit 2 të datës 08.06.1977, aktualisht e ndëshkueshme me nenin 146 dhe 147 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje "KPRK");

PROPOZOJ



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

Që pranë asaj gjykate të caktohet dhe të mbahet shqyrtimi gjyqësor verbal-publik, në të cilin duhet të ftohën:

- **Prokurori i shtetit i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës;**
- **I akuzuari**
 - Čedomir Aksić, apo t'i cakohet perfaqesues ligjor
- **I dëmtuari**
 - Isak Brahimi, rr. "15 Janari" nr. 16 – Reçak
- **Dëshmitaret -të dëmtuarit**
 - Ruzhdi Jashari, rr. "Komandante Kumanova" nr. 130, Shtime;
 - Sadri Jashari, rr. "Komandant Kumanova", Shtime;
 - Bashkim Rizau (Bashkim Shasivari), rr. "Vëllezërit Gjuka" nr. 32, Pejë;
 - Shukrije Hysenaj, rr. "Ramadan Rexhepi", hyrja 2 nr. 4, Ferizaj;
 - Agim Hysenaj, rr. "Egnjatia", Petrove/Shtime;
 - Hajdin Hyseni, rr. "Ramadan Mehmeti", hyrja II, nr. 5, objekti i TMKSë Ferizaj;
 - Blerim Hysenaj, rr. "Sali Ceku", hyrja A, kati 8, nr. 35, Ferizaj;
 - Hyzer Hyseni, rr. "Ramadan Mehmeti", hyrja II, nr. 5, objekti i TMK-së Ferizaj;
 - Njazi Mujota, rr. "Komandant Kumanova", nr. 198, Shtime;
 - Tefik Halili, fshati Reçak, Shtime;
 - Avdullah Krasniqi, rr. "Skënderbeu", nr. 37, Shtime.
- **Propozoj, që Gjykata në procedurën e nxjerrjes së provave materiale t'i administroj këto prova materiale që janë përdorë në kryerjen e veprës penale:**
 1. Lista e Kriminelëve të luftës në Kosovë, marrë nga uebfaqja "Wikipedia";
 2. Vërtetim për djegien e shtëpisë së Sadri Jashari – lëshuar nga Kuvendi Komunal Shtime, nr. 06/350/7062, datë 19.03.2007;
 3. Fotoalbumi i shtëpive të djegur gjatë ofenzivës së forcave serbe;



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

4. Proces mbi kryerjen e shikimit në vendngjarje – Kuvendi Komunal Shtime, nr. 07/1 datë 19.04.2002;
5. Letërnjoftim i të akuzuarit Čedomir Aksić lëshuar nga Republika Federative Jugosllave;
6. Raport policor post mortem i datës 10.06.2021 nga vendi i ngjarjes ku është bërë zhvarrosja dhe është siguruar prova materiale e cila ka qenë e vendosur në shishe të plastikës;
7. Letra e gjetur në varrin e Halil Hysenaj me tekst “Qeda e ka vrrarë Halilin”;
8. Kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë e lidhur në mes të Abdullah Krasniqi dhe Čedomir Aksić, datë 30.10.2002;
9. Raporti i Policisë nga Policia i datës 17.08.2021 nga vendi i ngjarjes ku është bërë zhvarrosja dhe është siguruar prova materiale e cila ka qenë e vendosur në shishe të plastikës së bashku me fotoalbum si dhe
10. Raporti i IML datë dhe numër lidhur me ekzaminimin e mbetjeve mortore të Halil Hysenaj.

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik, propozojmë që i pandehuri të shpallet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë dhe të dënohet sipas KPK-së.

ARSYETIMI

ASPEKTET PROCEDURALE

Me datë 07.02.2006, Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, pranoi Kallëzimin penal kundër të pandehurit Čedomir (Voimir) Aksić, paraqitur nga të dëmtuarit Ruzhdi Jashari, Sadri Jashari, Rexhep Jashari dhe Hamdi Jashari, me dyshimin se ka kryer veprën penale Krimi i luftës kundër popullsisë civile, e paraparë dhe sanksionuar me nenin 116 par. 1 pika 2 dhe 3 të KPK-së nenit 117 par.1 pika 4 dhe 8 lidhur me par 2 pika 1 dhe 4 të KPK-së. Mirëpo, me datë 26.02.2013, kësaj prokurorie i është dërguar kallëzimi penal së bashku me shkresat e lëndës.

Lidhur me parashtrimet e të dëmtuarve në Kallëzim penal, PSRK, me datën 07.04.2015, ka bërë Kërkesë për grumbullim të informatave. Ndërsa, duke vepruar sipas kërkesës për grumbullimin e informatave Policia e Kosovës, me datë 27.07.2027, ka dorëzuar Raport për veprimet e ndërmarra.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, prokurori i shtetit me datë 15.10.2019 ka marrë Aktvendimi për fillimin e hetimeve kundër të akuzuarit Čedomir (Voimir) Aksić për shkak të dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari Čedomir Aksić ka kryer veprat penale:
- Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës neni 150 i KPK-së;
- Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës, neni 152 i KPK-së pika 2.1 dhe 2.2; - Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

zakoneve që zbatohen në konfliktet e Armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, neni 153 i KPK-së; - Organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerizimit dhe krimet e luftës, neni 160 i KPK-së; - Përgjegjësia e komandantëve dhe përgjegjësive të tjera nga neni 161 i KPK-së; - Krime Luftë kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 dhe 22 të Ligjit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë.

Gjatë zhvillimit të procedurës hetimore, kjo prokurori lidhur me veprimet e të akuzuarit Čedomir Aksić, ka marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitareve edhe Shukrije Hysenaj dhe Agim Hysenaj. Nga dëshmia e këtyre dëshmitarëve rezulton se i akuzuari Čedomir Aksić, me datën 13 maj 1999 në vendin e quajtur Lugu i Neshës, në fshatin Petrovë të Shtimes, mori pjesë në vrasjen e tani të ndjerit Halil Hysenaj.

Andaj, kjo prokurori me datë 15.09.2021, mori aktvendim për zgjerim të hetimit për shkak të dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari Čedomir Aksić, me datën 13 maj 1999 në vendin e quajtur Lugu i Neshës, në fshatin Petrovë të Shtimes, mori pjesë në vrasjen e tani të ndjerit Halil Hysenaj, me çka dyshohet se me datën 13 maj 1999 ka kryer veprat penale: - Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës neni 150 i KPK-së; - Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës, neni 152 i KPK-së pika 2.1 dhe 2.2; - Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e Armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, neni 153 i KPK-së; - Organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerizimit dhe krimet e luftës, neni 160 i KPK-së; - Përgjegjësia e komandantëve dhe përgjegjësive të tjera nga neni 161 i KPK-së; - Krime Luftë kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 dhe 22 të Ligjit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë.

Po ashtu, nga provat e siguruar ekziston dyshimi i arsyeshëm se i akuzuari Čedomir Aksić, me vullnet dhe me vetëdije të plotë me datën 15.01.1999 në fshatin Reçak, Shtime, së bashku me pjesëtar tjerë tani për tani të pidentifikuar mori pjesë aktivisht në vrasjen e personave Skender Halili, Sadik Mustafa, Hajriz Brahimi, Haki Murati, Sabri Murati dhe Arif Murati dhe vajzës së Sadik Mustafa e moshës 16 vjeqare, andaj, PSRK, ka zgjeruar hetimin për shkak të dyshimit të arsyeshëm se me datën 15.01.1999 ka kryer veprat penale: - Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës neni 150 i KPK-së; - Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës, neni 152 i KPK-së pika 2.1 dhe 2.2; - Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e Armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, neni 153 i KPK-së; - Organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerizimit dhe krimet e luftës, neni 160 i KPK-së; - Përgjegjësia e komandantëve dhe përgjegjësive të tjera nga neni 161 i KPK-së; - Krime Luftë kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 dhe 22 të Ligjit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë, andaj PRSK, me datën 02.03.2023 PSRK,



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

Andaj, me datë 02.03.2023, ka marrë aktvendim për zgjerimin e hetimit kundër Čedomir Aksić, për shkak se ekziston dyshimi i arsyeshëm se i pandehuri Čedomir Aksić me datën 15.01.1999 në fshatin Reçak, Shtime, qashtu që së bashku me pjesëtar tjerë tani për tani të pidentifikuar mori pjesë aktivisht në vrasjen e personave Skender Halili, Sadik Mustafa, Hajriz Brahim, Haki Murati, Sabri Murati dhe Arif Murati dhe vajzës së Sadik Mustafa e moshës 16 vjeqare.

Ndërsa, pas ndërmarrjes së veprimeve të caktuara hetimore u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit Čedomir Aksić janë manifestua elementet e veprës penale siç është përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze.

Kjo prokurori ka tentuar që të akuzuarin Čedomir Aksić ta merr në pyetje lidhur me veprat penale për të cilat dyshohet, ashtu që me datë 21.10.2019, ka autorizuar Policinë e Kosovës për marrjen e veprime hetimore lidhur me të pandehurit Čedomir Aksić.

Por, nga Raporti policor i datës 22.10.2020, jemi njoftuar lidhur me veprimet e ndërmarra dhe se i akuzuari jeton jashtë Kosovës. Por, përkundër faktit se i pandehuri jetonte jashtë Republikës së Kosovës, nga ky raport po ashtu jemi njoftuar edhe për adresën e re jashtë Republikës së Kosovës, pra i njëjti kishte vendbanimin në Republikën e Serbisë.

Kjo prokurori ka autorizuar Policinë e Kosovës për marrjen në pyetje të pandehurit Čedomir Aksić, mirëpo nga Policia e Kosovës, me datë 16.06.2021 kemi pranuar raport se i njëjti jeton jashtë Republikës së Kosovës, gjegjësisht në Serbi.

Meqenëse, prezenca e të pandehurit në procedurë nuk është siguruar në mënyrë të rregullt, me datën 19.11.2020, PSRK ka paraqitur Kërkesë pranë Gjykatës Themelore Prishtine për lëshimin e urdhër arrestit kundër të akuzuarit Čedomir Aksić.

Me datë 27.11.2020 Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special ka lëshuar Urdhër arrest për të akuzuarin Čedomir Aksić.

Me datë 02.06.2021 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special me Kërkesë për letër rreshtim vendor dhe ndërkombëtar.

Me datë 03.06.2021 Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special ka urdhëruar lëshimin e Letër rreshtimit Qendror dhe Ndërkombëtar për të akuzuarin Čedomir Aksić përmes Ministrisë së drejtësisë – Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

Por, poashtu me qëllim që i pandehuri të merret në pyetje lidhur me veprat penale për të cilat dyshohet, me 24.06.2021 përmes Ministrisë së drejtësisë –



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të njëjtit i është dërguar ftesa në Republikën e Serbisë.

Me datë 01.11.2021 nga Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar kemi pranuar njoftimin se adresa në të cilën i është dërguar ftesa sipas adresës që e ka lënë i akuzuari në momentin e nënshkrimit të Kontratës për shitjen e paluajtshmërisë së tij në Komunën e Shtimes është e panjohur.

Po ashtu, kjo prokurori me datë 30.09.2021 ka bërë Kërkesë për Autorizim të hetimit edhe për gjashtë muaj. Mirëpo, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me Aktvendimin PPPS nr. 185/19, ka refuzuar Kërkesën e kësaj prokurorie me arsyetim se me ndryshimet e KPP është abroguar afati i hetimit tek veprat penale të krimeve të luftës.

Andaj, meqenëse me Kërkesën për Bashkëpunim Juridik, nuk është arritur qëllimi i paraparë me par. 4.1 dhe 4.2, bazuar në ndryshimet dhe plotësimet e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 06/1-091, par. 4 PSRK me datë 30.09.2021 ka paraqitur Kërkesë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit Special që kundër të akuzuarit Čedomir Aksić të bëhet Shpallja Publike.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special me datë 18.10.2021, me Aktvendimin PPPS nr. 185/19 ka refuzuar Kërkesën e kësaj prokurorie.

Kundër këtij Aktvendimi, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me datë 22.11.2021 ka paraqitur Ankesë ndaj këtij Aktvendimi pranë Gjykatës së Apelit.

Me datë 08.12.2021 Gjykata e Apelit ka vendosur dhe ka urdhëruar Gjykatën e Shkallës së parë që ta lëshoj urdhëresën për shpalljen në kërkim për hetim në procedurë penale të akuzuarin Čedomir Aksić.

Policia e Kosovës, duke vepruar sipas Urdhëresës së Gjykatës, me datë 02.12.2022 ka bërë Shpalljen Publike në mjete të informimit dhe gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

PSRK, me qëllim të vërtetimit të shkakut të vdekjes së Halil Hysenaj dhe sigurimit të provave materiale që mund të gjenden në varrin e tij, me datën 23.06.2021 ka kërkuar urdhëresë nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special për zhvarrosje post mortem autopsi dhe identifikim dhe shkakun e vdekjes së Halil Hysenaj.

Në prezencën e prokurorit të çështjes, Gjyqtarit të Procedurës paraprake, zyrtarëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe hetuesve policor, me datën 10.06.2021 është bërë zhvarrosja e trupit të Halil Hysenaj dhe është siguruar prova materiale e cila ka qenë e vendosur në shishe të plastikës dhe e cila është përputhur në tërësi me deklaratën e dëshmitarit Hyzer Hysenaj i cili ka deklaruar se gjatë varrimit të ndjerit,



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

lidhur me vrasjen e Halil Hysenajt ka bërë përshkrimin në një letër të cilën letër e kishte futur në një shishe të plastikës dhe e kishte varrosur bashkë me trupin.

Nga raporti i IML nr. TVD01-001B vërtetohet shkaku dhe mënyra e vdekjes së tani të ndjerit Halil Hysenaj.

Gjendja faktike në këtë çështje penale – juridike është vërtetuar nga këto prova:

- **Nga dëshmia e dëshmitarit - të dëmtuarit Ruzhdi Jashari të dhëne në Polici me datën 21.10.2020 dhe me 25.01.2021 në Prokurorinë Speciale, vërtetohet se gjatë kohës së luftës që nga fillimi i vitit 1998 deri në përfundim të luftës në Kosovë ka punuar dhe vepruar si gazetar dhe zëdhënës i UÇK-së për Zonën Operative të Nerodimes. U vërtetua se në afërsi të shtëpisë së tij ka pasur shtëpinë i akuzuari Čedomir Aksić, ka jetuar së bashku me babain e tij Mile dhe vëllain i e tij Staja Aksić, ka pasur shtëpinë e tij në afërsi të Čedomir. Dëshmitari tregon se Čedomir Aksić me përkeqësimin e gjendjes së sigurisë në Kosovë aktivizohet në policinë serbe në stacionin e Shtimes dhe sipas informacioneve ai ka qenë përgjegjës në pikën e quajtur "Te gështenjat", e cila gjendet në pjesën në mes Shtimes fshatrave Mulapolc, Reçak dhe Petrovë. Po ashtu nga ky dëshmitar-i dëmtuar vërtetohet se shtëpia e Čedomir ka shërbyer gjatë kohës së luftës 1998/1999 si strehë për forcat policore dhe paramilitare, pasi që për të ikur ndonjë sulmi eventual të NATO-së janë strehuar në shtëpinë e tij. Po ashtu dëshmitari vërteton se gjatë kohës së luftës, konkretisht nga prilli i vitit 1998 është detyruar që të largohet nga shtëpia për shkak të presionit dhe kanosjeve të vazhdueshme nga policia serbe për shkak të aktivitetit si gazetar (reporter lufte) për RTP, studion në Tiranë, Radio Deutche welle, Gazetar i agjensionit Kosova Press, Radio Kosova e Lirë, Zërit të Amerikës dhe BBC, si dhe për shak se në atë kohë ka ushtruar aktivitetin në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nga dy dëshmitar vërtetohet se kur është kthyer pas lufte tek shtëpia e tij, ka vërejtur se shtëpitë ishin rrafsh me tokë, ishin mbetur vetem gërmadhat, asgjë nuk kishte shpëtuar, e gjithë pasuria e ndërtuar gjatë viteve të 80-ta ishte djegur nga forcat serbe. Po ashtu vërteton se atë dite ka takuar fqinjët Nuhi Seferi (tani i ndjere) dhe Liman Bytyqi (tani i ndjerë) ata me njoftuan se në ditën kur u shkatërruan shtëpitë i kishte dëbuar Čedomiri i njohur me emrin Qeda dhe sipas fqinjëve shtëpitë ishin shkatërruar me eksploziv nga policia serbe ku kishte marre pjese edhe Čedomiri. Tutje ka deklaruar se shtëpi të cilat kemi dyshimin e bazuar se janë shkatërruar nga policia serbe në krye me Čedomir Aksić, pasi që i njëjti duke e ditur veprimtarinë time dhe aktivitetin në çështje kombëtare ka dashur të hakmerret mua dhe familjes sime. Po ashtu ka deklaruar se nga evidencat e dëmeve të shkaktuara në luftë mund të them se janë dëme të mëdha në vlerë prej mbi 300,000 euro dhe për dëmet e shkaktuara kam disa foto me të cilën vërtetohen se shtëpitë tona janë në kategorinë V të dëmtimeve të cilat i ofroj si dëshmi.**
- **nga dëshmitari- i dëmtuari Sadri Jashari, në deklaratën e dhënë me datë 21.10.2020 në polici dhe me 25.01.2021 në Prokurorinë Speciale deklaroi se pasi u njoftua lidhje**



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

me hetimin që është duke u zhvilluar kundër Čedomir Aksić, dëshmitari- i dëmtuari i deklaron se nuk më kujtohet data e sakta por sa më kujtohet në muajin Prill të vitit 1999 forcat serbe kanë vendosur eksploziv në shtëpitë tona dhe të njëjtat i kanë shkatërruar plotësisht. Katër shtëpitë tona kanë qenë tri katshe dhe të ndërtuara me material ndërtimor të fortë, të gjitha të mobiluara ndërsa në pjesën e jashtme nuk kanë qenë suvatuara. Përveç katër shtëpive të shkatërruara ka qenë edhe një shtëpi një katëshe si aneks ku bënim ndjen gjatë ditës. Shtëpitë kanë qenë të ndara me një mure dhe me dy hyrje, njëjtë ka qenë edhe shtëpia tjetër për katër vëllezër ndërsa shtëpia e vogël një katshe ka qenë rreth 50 metra katror. Vlen të theksoj se në atë periudhë kohore kemi jetuar së bashku me katër vëllezërit unë, Sadriu, Ruzhdiu, Rexhepi dhe Hamdiu, pra një familje rreth 34 anëtarësh. Shtëpitë tona kanë qenë rreth 300-400 metra nga stacioni i policisë së vjetër ndërsa përball e kam pasur fqinjin serb Čedomir Aksić. Dyshimet e mija janë se fqinji Čedomir Aksić është personi i cili i ka shkatërruar pesë (5) shtëpitë tona, meqenëse i njëjti ka pasur sjellje shumë të këqija dhe pas luftës jeton në Serbi dhe asnjëherë më nuk është parë në Shtime kurse vëllai i tij jeton në Llapnasell afër Graçanicës. Čedomiri ka qenë rreth 35-40 vjeçar dhe para vitit 1998 ka jetuar si arsimtar ndërsa në kohën e luftës ka shërbyer si polic në stacionin policor në Shtime, e them këtë sepse në fund të dhjetorit të vitit 1999 kur unë së bashku me vëllezërit jemi kthyer në shtëpi dhe kemi qëndruar rreth 3 javë për festat e fund vitit më kujtohet se në atë kohë e kam parë shpesh Čedomirin të veshur me uniformë policore me ngjyrë të kaltër dhe pistoletën në brez. Marrëdhëniet fqinjësore me fqinjin tonë Čedomirin kanë qenë të mira deri në vitin 1998 mirëpo, nga kjo periudhë kohore i njëjti nuk na ka folur asnjëherë. Fqinjët tanë tani të ndërë kanë qenë dëshmitar kur janë shkatërruar shtëpitë dhe të njëjtit na kanë treguar se policia serbe së bashku me paramilitar serb janë parë në oborrin e shtëpive tona të cilat pastaj iu kanë vendosur eksploziv dhe shkatërruar plotësisht.

- nga dëshmitari- i dëmtuari **Bashkim Rizahu**, në deklaratën e dhënë me datë 01.06.2021 dëshmitari - i dëmtuari deklaron se në kohën e luftës unë kam qene në moshën 17 vjeçar dhe e njoh Čedomirin ka qene shumar dhe ai e ka njohur terrenin e Shtimes dhe malet, mirëpo në kohën e luftës që ndërëlidhet me vitet 1998-1999, i njëjti deklaron se Qeda në atë kohe ka qene i veshur me uniforme policore dhe shumica e materialeve ushtarake kane dale nga shtëpia e Čedomirit. I njëjti deklaron se në janar të vitit 1999 kam qëndruar në shtëpinë time se bashku me babin tim e kemi vëzhguar gjithë situatën dhe kemi pare persona që kane qene në uniforma policore (jo ushtarake) gjate tere kohës në kemi qëndruar në shtëpinë tone sepse në nuk kemi qene të sulmuar, sulmet kane filluar në Reçak diku në ora 5 të mëngjesit dhe kane zgjatur afërsisht deri në ora 9, kemi qene të frikësuar dhe kemi qene të përgatitur në çdo moment të përgatitur se mund të ndodh diçka. Atu kemi qene e gjithë familja në shtëpi, ate dite me vone kane pushuar sulmet dhe e di se me vetura e OSBE-së kane ardhur njerëz me mision, me kujtohet se pjesëtar të misionit OSBE-së kane kerkuar nga një fshatar i yni që tani nuk jeton me Nuhi Seferi që ti dërgoj deri në fshatin Reçak, me tu kthyer në fshat Nuhi Seferi a ka treguar se serbet kishin kryer masakër në Reçak, po ashtu për shkak të sigurisë se personit Nuhi Seferi

2020:0005588



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

zyrtare e OSBE-së janë kthyer prape deri në Shtime ku edhe na kane njoftuar se kishte pare njerëz të masakruar. Gjate gjithë kohës kur janë djegur këto shtëpi i njëjti ka qene në vend të ngjarjes, kur eshte djegur shtëpia e Ruzhdi Jasharit i njëjti ka deklaruar se ka qene në shtëpinë e Nuhi Seferit e cila është përballë me shtëpinë e Jashareve, në ishim duke bere roje se mos po ndodh diçka në lagje dhe kjo ka ndodh diku gati para përfundimit të luftës, mund të jete diku 1 muaj apo 1 muaj e gjysme. në atë kohe janë djegur shume shtëpi njëra nder to ishte edhe shtëpia e Ruzhdi Jasharit, shtëpia ishte djegur për shkak se i njëjti ka qene pjesëtar i UÇK-së dhe ka qene gazetar që kane raportuar për ngjarjet në zonën e Nerodimes, i njëjti deklaroi se pas dy ditësh policia ka hyre në lagjen tone dhe kane gjuajtur me arme në drejtime të ndryshme dhe kane sulmuar shtëpitë e gjdo qytetari të lagjes. Kane hyre në shtëpitë e lagjes gjate asaj kohe unë e kam pare duke ardhur në lagje Liman Bytyqi dhe Sadik Arifi të cilët kishin qene të rrahur nga forcat serbe, dhe kjo kishte ndodhur në shtëpitë tona dhe u takuam në fund të lagjes me qellim që të jemi me të sigurte dhe me qellim që të largohemi të gjithë se bashku, në momentin në e pame të rrahur Sadik Arifin dhe i njëjti na tregonte çka kishte ndodhur në shtëpinë e tij ai ende e kishte një kornizë në të cilën kishte qenë fotografia e Skenderbeut në shtëpinë e tij dhe me të njëjtën e kishin goditur në koke ndërsa korniza i kishte mbetur ende në qafe sepse nuk mund ta heqtë për shkak të xhamave të kornizës dhe ai na tregoi se ishte rrahur nga policet serb. Shtëpia e Qedes ka qenë në fillim të lagjes dhe nuk me kujtohet sakte diku pasi është sulmuar shtëpia e parë mund të jetë një ditë apo dy ditë diku rreth orës 15 apo 16 kemi dëgjuar krisma të armeve i njëjti deklaroi se ishte me prindërit e tij dhe atë kishte parë forca të shumta policore diku rreth 20 persona të uniformuar disa me uniforma të zeza disa me uniforma me lara prej tyre disa kishin shamia të zeza e disa kishin shirita të kuq në krah dhe pasi u ndërpreu gjuajtjet e forcave serbe të njëjtit hynë në shtëpinë e Ruzhdi Jasharit, disa prej forcave serbe janë ndalur. Nga deklarata e këtij dëshmitari të dhënë me datën 27.07.2015, vërtetohet se i akuzuar Čedomir Aksić, ka qenë i uniformuar dhe duke biseduar me pjesëtar të tjerë të forcave serbe kur janë djegur shtëpitë e Jasharajve.

- nga dëshmitari-e dëmtuara Shukrije Hysenaj e cila në deklaratën e dhënë me datë 16.02.2021 ka deklaruar se bashkë me burrin e saj Halilin dhe fëmijët si dhe të gjithë banoret e fshatit Petrov dhe fshatrave për rreth janë vendosur në malet e fshatit Patrovë në drejtim të maleve të Jezercit, se ishte luftë dhe forcat serbe gjuanin me granata në oborre tona po ashtu na gjuani edhe me arme. Dëshmitarja ka deklaruar se pasi u vendosem në ato male në kemi bere disa llastika (serra) dhe kemi qëndruar në këto llastika duke e bërë jetën për me se keqi, se fëmijët i kishte të vegjël nga mosha 9-13 vjet dhe mundësia që ti ushqej dhe ti pastroja ishte shume e vogël. Kështu, dëshmitarja ka vërtetuar se që me datën 13 maj 1999 diku rreth orës 12 derisa ishin në llastika ka dëgjuar disa zhurma të shumta dhe menjëherë janë ngritur dhe janë dal nga llastiku dhe janë nisur në të drejtim të malit që qonte në drejtim të fshatit Petrove pasi zhurmat u ndiheshin nga pjesa e Jezercit. Dëshmitarja se ka deklaruar se unë isha se bashku me burrin dhe fëmijët si dhe me neve ishin edhe dy fqinjët tanë Agim Hysenaj dhe Bajram Hysenaj, pasi kemi ecur diku rreth 30 min



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

por u lodhem me nuk kemi mundur të ecim jemi ndal për pak kohe për të pushuar. Tutje ka deklaruar se derisa ishim duke pushuar burri im Halili me tha rrini ju këtu unë po shkoj pak me larte që të shikoje se kush janë këta që po bëjnë zhurme UÇK-ja apo policia serbe. Kështu që Halili shkoi une mbeta me tre fëmijët dhe me fqinjët, në atë vend pritem rreth 10 min, Halili nuk u kthye kështu që Agimi shkoj në drejtim të Halilit që të shikoje se ku mbeti dhe nuk vonoje shume u kthye Agimi shume i shqetësuar dhe me tha "o ikni se shkijet" Halilin e kish zënë Qeda. Agimi se bashku me Bajramin dhe dy djemtë e mi 8 vet dhe 5 vjet menjëherë ikëm në drejtim të fshatit kurse dëshmitarja ka deklaruar se kishte mbetur me djalin e vogël Arjanitin 3 vjeq. Po ashtu ka deklaruar se papritmas po e dëgjoj nje ze të burrit tim duke thene "oj Shukri ku je" fillimisht e nejta deklaroi se nuk guzoja të lajmerojet mirëpo, burri vazhdimisht me thërriste "oj Shukri ku je se spom besojnë këta që jam me ty dhe fëmijët, pastaj erdhën policia serbe ishin të uniformuar me uniforme të kaltër me lara në radiolidhje me dike ku e informojshin dikë se kane nxen nje bure me një grua dhe me fëmijë. Pastaj e murrën urdhrin ta marr burrin kurse mua me than të qëndroj aty ulur në male derisa të kalojnë policia që pastaj të largohem nga aty. Aty ishin rreth 100 persona aty kam pa edhe uniforma të ushtrisë serbe ngjyre të gjelbër duke kaluar policia dhe ushtria njeri nga policet u ndal dhe na dha ushqim për fëmijët pasi djali qante dhe nuk u ndalte, kolona e policisë dhe ushtrisë ishte shume e gjate. vazhduam të ecim neper male me dy djemtë e mi Valmirin dhe Jetmirin dhe me fqinjët mije Bajramin dhe Agimin dhe jemi takuar me banor tjerë që ishin ende duke qëndruar në disa llastika. të nesërmen tere ditën prita që po kthehej burri ime Halili por aj nuk u kthye kështu që në orët e mbrëmjes fqinji ynë Nezir Hysenaj me tregoj se Halilin e kishte gjetur të vrare. Atë dite pra me 14 maj 1999 e kane gjetur të vrare burrin, kurse të nesërmen me 15 maj 1999 burrat e fshatit dhe kuantit Hajdini e kishin varrosur në varrezat e fshatit Petrovë, nga fqinjët dhe kunati i saj Hajdini Pastaj në u kthyem në shtëpi, shtëpia ishte djegur.

- nga dëshmia e dëshmitari- i dëmtuari Agim Hysenaj, dhënë me datë 25.02.2021, vërtetohet se ka qene muaji maj 1999 ishte kohe lufte, se ka qene i strehuar në malet e Petrovës se bashku me shumë banore të fshatit dhe fshatrave për rreth, u strehuam atje sepse nuk kishim ku të rrinim sepse policia she ushtria serbe u dogji shtëpitë dhe me nuk ishim të sigurt që të rrinim në fshat. Në atë kohe i kujtohet se ishte kohe ishte kohe e nxehte dhe ishim duke qëndruar në atë pjese e livadhit që quhet "livadhi i Neshes", aty isha unë i vendosur se bashku me fqinjin Bajram Hysenaj, Halil Hysenaj me gruan Shukrijen dhe tre djemtë e tij të vendosur në serra (llastika që flinim në te). Tutje ka deklaruar se papritmas kemi dëgjuar disa zhurma tjera të njerëzve, por sakte nuk e dinim se çfarë u ba, i njëjti ka deklarua se bashke me fqinjën e tij Bajramin dhe Halilin me familjet e tyre kemi filluar të ikim nga livadhi në drejtim të fshatit Petrov, kemi ecur rreth disa min dhe jemi ndalur, Halili na tha ulnu ju këtu se une po dal me shiku se mos janë UÇK-ja. Vendi ku qëndronin ku u ulem quhet "Guri i Livadhit" i cili gjendet rreth 100-150 metra nga livadhi ku qëndronin të strehur, pasi shkoj Halili në mbetem duke e pritur se qysh është situata pritem rreth 5-10 min. Halili nuk u kthye, atëherë une i thash dhe gruas se Halilit se po



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

shkoj të shikoj se ku mbeti Halili, papritmas e kam vërejtur se Halili ishte ulur (kacul) afër shpatit dhe afër tij qëndronte afër i ulur në të njëjtën pozite shumari Qeda nga Shtimja. Qeda e mbante nje arme të gjate 10-she ai ishte i veshur me uniforme të ushtrisë serbe, pash që Qeda ishte duke e marr në pyetje Halilin por nuk me kujtohet se qfare flisnin. Atë nate kemi qëndruar në atë vend që quhet Rrafshi i Mrizit, atje kishte pasur edhe shume fshatar të fshatit tone. të nesërmen disa nga fshataret na kane treguar se Halilin e kane gjetur të vrare në rruge afër shtëpisë se Basri Hysenaj në hyrje të fshatit. të nesërmen kemi shkuar bashke me Hyzerin, Hasanin dhe Basria edhe e kemi pa trupin e vrare të Halilit, e kemi marr dhe e kemi vendosur në qebe (batanije) dhe burrat e kane dërguar në shtëpinë e Halilit.

- nga dëshmitari- i dëmtuari Blerim Hysenaj, në deklaratën e dhënë me datë 08.06.2021 në Polici, dëshmitari- i dëmtuari deklaroi në lidhje me vrasjen e fqinjët të tij Halil Hysenaj në mesin e vitit 1998 bashke me nene time Taiben patëm ikur nga shtëpia jone për shkak të dhunës se forcave serbe që ushtronin mbi popullatën shqiptare në fshatin tone, pastaj hyri KFOR-i në Ferizaj me 12 qershor me kujtohet si date se pata bere disa CV dhe kërkoja pune pasi që unë e njihja gjuhen angleze, kështu që me datën 13 apo 14 qershor 1999 e dërgova një letër CV në ndërtesën e komunës atë ishte stacionuar KFOR-i Amerikan dhe pasi lash kërkesën pash se në afërsi të stacionit të trenit ishin grumbulluar me serb civil (gra, fëmije pleq meshkuj) të gjitha moshave të cilët ishin nën mbikëqyrje të KFOR-it. Fqinjët me thane se po e shohin Qeden që ishte atë dhe me than pasi e dine gjuhen angleze lajmërojë oficeret amerikan dhe tregoj se Qeda është ai që e ka vrare Halil Hysenaj, oficeri amerikan tha se këto informacione do i përcjellim me larte por nuk mundemi të arrestojmë kete njeri tani për tani, nëse aj ka vrare njëres drejtësia ndoshta vonon por ky njeri Qeda do të arrestohet i kishte thënë oficeri amerikan i KFOR-it përkthyesit Blerim, të nesërmen e kam pare prape Qeden pasi nuk kishin mundur që atë dite KFOR –i ti siguroje transport serbeve që të largohen të sigurt nga Kosova.
- nga dëshmitari- i dëmtuari Hyzer Hysenaj, në deklaratën e dhënë me datë 08.06.2021 në polici, dëshmitari- i dëmtuari deklaroi në lidhje me rastin e vrasjes se Halil Hysenaj, i njëjti deklaroi se ishte muaji maj 1999 kohe lufte kur policia dhe ushtria serbe vrisnin civil, digjnin shtëpi na dëbuan nga shtëpitë kështu që jeta jone ishte në çdo qastë e rrezikuar gjate kohës se luftës, me sa me kujtohet ishte data 12 apo 13 maj 1999 kur forcat serbe e rrethuan fshatin Petrove dhe fshatrat për rreth Reçak, Mullapolc, Dremjak, Llanisht, Topille etj këto forca në këmbësori pastronin terrenin neper fshatra dhe male, kështu që mundësia për të qëndruar në shtëpi nuk ishte për shkak të frikës nga forcat serbe, ishim shume të frikësuar sepse me 15 janar 1999 forcat serbe kishin vrare shume civil shqiptarë në fshatin Reçak i cili fshat ishte vetem 2-3 kilometra larg nga fshati yne. kështu që në detyrimisht dolëm nga shtëpitë tona dhe jemi strehuar familjet tona mbi fshatin Petrovë në male e quajtur “Mrizet e medhaja”, ashtu kemi bere disa tende najloni dhe jemi strehuar shume familje tona, atë ishim vendosur dikund rreth 2000 civil të fshatit tone dhe fshatrave për rreth. I

2020:0005588



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

njëti deklaroi se diku ka ora 16:00 apo 17:00 është ardhur gruaja e Halilit me dy fëmijët e tij dhe me fqinjën Agim Hysenaj, gruaja e tij na tregoi se Halilin e kishin nene forcat serbe dhe e kishin ndaluar, ndërsa Agimi na tregoi se e kishte parë me sytë e tij që e kishin ndaluar Halili serbi i Shtimes Qeda (shumari). Të nesërmen me datën 14 maj 1999 disa nga banoret që ishim në atë vend strehim Basri Hysenaj dhe Jahjush Hysenaj kanë shkuar në fshatin Petrove që të marrin gjera ushqimore dhe të shikojnë se çka ka ndodhur në fshat, atëherë në afërsi të shtëpisë së Basri Agush Hysenaj në një renovim (gropë e ceket) e kishin hasur kufomën e Halilit, Basria dhe Jahjushi u kthyen prapë në mal dhe na treguan që e kishin gjetur Halilin e vrare në afërsi të shtëpisë së Basriut. të nesërmen e kemi varrosur Halilin në varrezat e fshatit Petrovë. i njëti deklaroi se pasi e vendosem kufomën në varr kam marr një cope letër dhe e kam shënuar emrin Halili Hysenaj dhe e kam shënuar Qeda e ka vrare Halilin dhe e kam vendosur në një shishe të plastikes.

- nga dëshmitari- i dëmtuari Hajdin Hysenaj, në deklaratën e dhënë me datë 07.06.2021 në Polici, dëshmitari- i dëmtuari deklaroi në lidhje me rastin e vrasjes së vëllait të tij Halil Hysenaj, i njëti deklaroi se gjatë kohës së luftës ka qenë pjesëtar i UÇK-së në zonën operative Nerodime dhe në atë kohë vëllai im bashkë me bashkëshorten e tij Shukrijen dhe fëmijët kanë qenë në shtëpinë tonë në Petrove. Ka qenë muaji maj 1999 kur derisa isha në Rance në bazën e UÇK-së, komandant i zonës Shukri Buja me thirrje dhe me njoftime se ishte gjetur i vrare vëllau im Halili, ai me tha se kufoma e tij është afër shtëpisë së Basri Hysenaj-djali i Agushit në Petrove, pastaj atë ditë unë jam kthyer në fshatin Petrovë kur erdha të shtëpia e Basri Hysenaj-kam takuar personat fqinjët Hyzyr Hysenaj, Basri Hysenaj, Agim Hysenaj, VBajram Hysenaj, Nijazi Hysenaj, mahmut Hysenaj, Sali Hysenaj, Ramadan Hysenaj, ata kishin qenë duke qëndruar pranë trupit të vrare të vëllaut tim, kishin ardhur për të me shprehur ngushëllime dhe Agim Hysenaj me tha se me sytë e mi e kame parë që Qeda e ka ndaluar Halilin në male, pastaj jam afruar para kufomës dhe e kam parë që kishte qenë i goditur me një plumb në pjesën e përparme të fytyrës së plumbin e kishte pasur afër syrit, pastaj ja kame parë që trupin e kishte të mavijosur nga dhuna fizike që ju kishte bërë, Halili në atë kohë ishte në moshën 42 vjet, atë ditë kemi varrosur vëllain Halilin së bashku me fqinjët e fshatit në varrezat e fshatit Petrovë, me kujtohet se kur është varrosur Halili në varreza fqinj im Hyzer Hysenaj ka vendosur një shishe plastike dhe e ka vendosur një shënim "Qeda e ka vrare Halilin", pas përfundimit të luftës për afërsisht një muaj pas lufte kishte ardhur fqinje i parë Qeda dhe me pyetje se a dëshiron të bleni trollein e tij, dhe i njëti deklaroi se i kishte thanë fqinjit Limanit se unë nuk dua të blejë prone të tij por dua ta takoj Qeden se ai ka vrare vëllaun tim Halilin, Pas luftës një djalë i ri i quajtur me emrin Blerim Shefqet Hysenaj ishte përkthyer në KFOR –Ferizaj e kishte parë Qeden të stacioni i autobusëve në Ferizaj dhe menjëherë ishte afruar dhe kishte biseduar me të, Qeda i kishte thënë se kishte qenë i detyruar që ta vras Halilin me urdhër të shtetit, Blerimi e kishte lajmëruar KFOR-in, ushtaret e KFOR-it e kishin ndaluar Qeden dhe Blerimi e din ngjarjen me mirë kishte thënë Halili në deklaratën e tij.



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

- nga dëshmia e dëshmitarit –të dëmtuarit Nijazi Mujota të dhënë në polici me datën 23.10.2020 vërtetohet se me datën 15 janar 1999, i kujtohet konkretisht masakrëa e Reçakut. Dëshmitarti ka deklaruar se atë kohe ka qene pjesëtar i UÇK-së dhe me datën 14.01.1999 deri në ora 01.00 isha roje në pjesën ku quhet “ Qeste”. në mëngjesin e hershem të datës 15.01.1999 ka deklaruar se ka dëgjuar krisma të armeve kur kam dalë në rrugë që të shkoj tek për përforcime tek UCK –ja (komanda) ishte takuar me Agim Ismajlin dhe Shaban Ndreca. Po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari vërtetohet se ditën kritike është plagosur në këmben e majte mbi gju. Dëshmiari ka deklaruar se pasi ishte ndare nga grupi se kishte pare motrën e tij (Hanumshahe Sadik Mujota) të vrare dhe nuk kishte arritur të shkoj deri atje pasi kishte shume gjuajtje me arme ndaj tyre. Por, dëshmitari ka deklaruar se kemi vazhduar të tërhiqemi deri sa kemi arritur të strehohemi tek Vrella dhe nuk kemi lëvizur deri kur ka ardhur një djal i ri Mentor Halili i cili ishte i tmerruar duke thënë “ o i kanë vra krejt”. Dëshmitari tutje vërteton se me 15.01.1999 se bashku me disa pjesëtarë tjerë të UÇK-së ka arritur të shkojmë disi deri në spitalin ushtarak në shkollën e Llanishtit ku kam qëndruar deri me datën 17.01.1999. Po ashtu dëshmitari ka deklaruar se kur është kthyer në fshatin Mullapol të Xhamia ka shkuar ku ishin të vrare motra ime, babi dhe shume persona të tjerë. Përveç vrasjeve të anëtareve të familjes deklarom se të njëjtëve iu është shkaktuar edhe dëm material, i eshte djegur shtëpia se bashku me dy objekte përcjellëse dhe gjithçka ishte shkatërruar, 2 kuaj ju kishin vrare si dhe të gjitha demet që ju kishin bërë nga forcat serbe kapin shumen 200.000 DM (dyqind mijë marka gjermane). Mirëpo, dëshmitari ka deklaruese se sa i përket personave që kane marre pjese në krimet e kryera në lagjen tone, nuk mund të them për ndonjë emër dhe mbiemër për shkak se në atë kohe ka qene mjaftë e shqetësuar i kishte fëmijët me vete dhe është frikësuar se mos fëmijëve po ju ndodhe diçka e keqe. Tutje dëshmitari – i dëmtuari shton se serbet të cilët kryen krime ato dite gjegjësisht me datën 15.01.1999 i kam njohur, nuk i di sakte me emra dhe mbiemra por nëse i shoh me fotografi i njoh. në fund deklarom se nëse arrin të siguroj prova se me të vërtetë ky person ka kryer vepër penale kërkoj që ky person të dënohet sepse përveç që ka qene i përfshirë në vrasjen e familjareve të mi në na është shkaktuar edhe dem material në atë mënyrë që shtëpitë janë rrënuar në tërësi, andaj pasojat e këtyre krimeve në i ndejmë edhe sot;
- nga dëshmia e dëshmitarit –te dëmtuarit Tefik Halili të dhënë në prokurori me datën 11.11.2020 dhe në polici me datën 27.02.2023, vërtetohet se me datën 15 janar 1999, nga forcat serbe janë vrare rreth 41 civil në fshatin Reçak. në ditën kritike të masakrës se Reçakut rreth orës 06.45, derisa i njëjti ishte duke qëndruar në shtëpi, papritmas ka dëgjuar se një shpërthim i madh si lloj detonimi ku ka pare se ushtaret e UÇK-së ishin dale në rrugë dhe disi ishin trazuar. Dëshmitari ka deklaruar se i ka pyetur pjesëtarët e UÇK-së, se e çfarë po ndodhe, por asnjeri nuk ma kthej përgjigjen. Pastaj, ka deklaruar se e ka thirr Skenderin (djalin e axhës) dhe nipi i tij Mentori në atë kohe ishte 16 vjeç, dhe janë nis në drejtim të malit, pra afër ishte edhe baza e UÇK-së. Nga ky dëshmitar vërtetohet se kur është ofruam afër shtëpisë se



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

Shyqyeri Mustafa ku ishte baza e UÇK-së, nuk ka pare asnjë nga ushtaret e UÇK-së, por deshmitari tutje ka shtuar se kemi vazhduar tutje duke ecur edhe pak deri jemi ndalur tek plemja e Ahmet Mustafes, kjo ishte shtëpia e pare e fundit afër malit, derisa shkuam në atë pleme disa here forcat serbe na kane gjuajtur edhe nga 'Qesta' por edhe nga pjesa e malit sepse pozicionet e UÇK-së që ishin mbi Reqak i kishin pas marre policia dhe ushtria serbe. U ndalem bashke me Skenderin në qosh të plemes se Ahmetit pas pak minutave po vjen plaku Hajriz Ibrahim vetëm i cili ecte në drejtim të malit papritmas e kap një plumb dhe ka rene për toke, dhe pas 10-15 min policet serbe u afruan afër Hajrizit që ishte i shtrirë dhe e goditen prape për se rati. Tutje, dëshmitari ka deklaruar se me vone edhe tre pleq që i njoha si Hakin, Sabri dhe Arif Murati, që të tre vëllezër ata kane ecur në drejtim të malit dhe kur kane arritur rreth 30-40 afër ku une isha, ata kaluan një përrocke dhe në atë moment i kane gjuajtur policia serbe dhe të tret kane mbetur të vdekur në vend. Nga dëshmia e deshmitarit vërtetohet se pas vrasjes se tre vëllezërve Murati, rreth 20 policë serb pak minuta me vone i goditen edhe tre pleq të tjerë me plumb për se afërmi. Nga ky deshmitari pa mendyshihe vërtetohet se i njëjti i ka njoftur disa nga policet serbe të cilët i goditen me plumba pleqtë si Zoran Stanojeviq nga Graçka e Lipjanit, pastaj i njëjti vërtetohet se e ka njohur shumari Čedomir Aksić i njohur si (Qeda). Dëshmitari deklaroi se ata i ka njohur edhe me heret dhe i njoh nëse i shoh e foto pa asnjë problem. Tutje, dëshmitari deklaroi se bashke me Skenderin ka qëndruar në plemen e Ahmetit rreth 30-50, pastaj policet serb zbriten dhe u vendosen në shtëpinë e Ahmetit, ata thyen derën me force dhe e nxorën Ahmetin, gruan e tij Salen dhe Mentorin dhe djali Mentori ishte strehuar të Ahmeti, dhe pak minuta me vone policia serbe e nxorën jashtë Ahmetin dhe e vranë në prezence të bashkëshortes Sala dhe djalit Mentorit, pastaj e kapen Mentorin dhe e shtyenin here të njeri here tek tjetri por se di si ka mundur të shpëtoj Mentori pas gjithë atij maltretimi, me kujtohet nena e tij Sala duke bërë titur " o ma bre mos e vrani se ky është fëmi", Mentori iku nga aty policia e gjuajtën nga pas por nuk e di si nuk e rroken, pas pak policia zbriten të poshtë drejtim të brendisë së fshatit unë dhe Skenderi kur e pamë se nuk kishte më police serb, atëherë jemi dal nga plemja dhe jemi ngjite përpjetë malit kur kemi mbërri të një cev afër proçkës e kemi takuar Sadik Mujoten i cili ishte veshur me rroba civile dhe kishte në dore një arme të tipit Snajperk dhe në brez kishte dy granata dore i treguam Sadikut se qfare pamë dhe vendosen që të ikim dhe të vendosemi në shtëpinë e Mehmet Mustafes, duke kaluar një trine ishte si rrethoje e oborrit, për një moment kemi dëgjuar të shtëna rrafall të shumta, dhe Sadiku ra për toke i vdekur, tutje dëshmitari theksoj se Skenderi u plagos dhe mbeti i shtrire në toke, fatbardhësisht mua nuk më kapi asnjë plumb. Kështu që i njëjti deklaroi se kam ikur ashtu nëpër plumba dhe jam hyre brenda në shtëpinë e Mehmetit brenda në shtëpi kishte qenë edhe gruaja e Sadikut, vajza e tij Hanumshahja dhe reja e tij Zyla i njëjti deklaroi se Sadiku ishte qëlluar nga policia serbe, nuk pate asnjë menyre që të ndaloje Hanumshahen vajzën e Sadikut ajo doli nëpër plumba që të shkoje ti ndihmoje babet të saj Sadikut. Në momentin e pare kur u ofrua e dëgjova një polic duke thënë citoje "ovaj Pushka je moja" ishte fjala për snajperken e Sadikut, pastaj kam dëgjuar britmën e Skenderit aq shume i goditen për se rati prap që të sigurohen se ai ka vdekur. në jemi dal, pra une gruaja dhe reja e Sadikut pas shtëpisë dhe jan

2020:0005588



Numri i lëndës: 2020:0005587

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 02476388

fshehur nga policia, por ata kishin hyre brenda dhe nuk na kishin vërejtur. Pas pak jemi dal në oborr dhe kemi pare se Mehmeti Mustafa ishte i shtrire në toke para derës së shtëpisë se tij ai ishte i vrar, pastaj shkuam të Skenderi dhe Sadiku, aty pash se Skenderi e kishte gjysmën e kokës së qare, Sadiku ishte i goditur me plumb në balle vajza e tij Hanumshahe ishte e vdekur mbi trupin e Sadikut. Pra, nga dëshmia e dëshmitarit Tefik Halilit vërtetohet se atë dite i akuzuari Čedomir Aksić Qeda-shumari, ishte i veshur me uniforme të policisë serbe ngjyre të kaltër i moshës rreth 40 vjeçar, ka qenë banor i Shtimes dhe paralufte ka punuar si roje pylli (shumar), polici Zvonko në ditën kritike kur i kanë vrare pleqtë në afërsi të shtëpisë se Ahmetit ai ishte i uniformuar me uniforme të policisë serbe ngjyre të kaltër dhe i armatosur. Nga dëshmia e këtij dëshmitari rezulton se të gjithë të vrarët si Hajriz Ibrahim, Haki Murati, Sabri Murati, Arif Murati, Ahmet Mustafa, Skender Halili, Sadik Mujota, Hanumshahe Mujota, Mehmet Mustafa i ka pare duke i vrare policia serbe në ditën kritike dhe se në vrasjen e këtyre qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë ka marre pjese i akuzuari Čedomir Aksić i cili ka qene edhe i uniformuar.

- nga dëshmitari- i dëmtuari Avdullah Krasniqi, i cili në deklaratën e dhënë me datë 10.06.2021, ka deklaruar se lufta në Kosovë na detyroje që të ikim dhunshëm nga shtëpitë tona e në atë kohe jetonim në fshatin Karaqice të Shtimes. Atje kishte dy shtëpi nga një katërshe dhe jetonim rreth 20 anëtare të familjes se bashku me familjet e vëllezërve të mijë. Kështu, për shkak të rrethanave të luftës unë se bashku me familje e pese vëllezërve jemi detyruar që t ikim dhe kemi shkuar në Maqedoni, atje kemi qëndruar deri me datën 27 qershor 1999 pasi hynë forcat paqeruajtëse të KFOR-it në Kosovë, pastaj jemi kthyer në Kosovë se bashku me familjet tona në fshatin Kaqacice, kur jemi kthyer shtëpitë tona ishin djegur dhe nuk kishim mundësi që të banojmë në to, i njëjti se bashku me familje kishte shkuar në qytetin e Shtimes duke shikuar se ku mund të vendoset, aty kishte pare një shtëpi të një serbi e cila ishte e zbrazet kjo shtëpi ishte në qoshe që kthehet në fshatin Godanc, aty kemi qëndruar deri në vitin 2004 derisa e ndërtoam shtëpinë që kishte pasur. I njëjti deklaroi se në vitin 2002 është lajmëruar Čedomir Aksić përmes avokatit Nexhat Qorolli dhe kishte kërkuar Čedomiri që të shiste shtëpinë tij, i njëjti tregon se i thash avokatit se nuk mundem ta blej shtëpinë e një serbi pasi ata mi kane djeg dy shtëpitë e mija. I njëjti thekson se pronën e tij e kishte blere pastaj Halit Hoxha.

Gjendja faktike në ketë çështje penalo-juridike u vërtetua nga provat materialë si:

1. Nga lista e kriminelëve e nxjerrë nga uebfaqja Wikipedia vërtetohet se në mesin e kryerësve të veprave penale – kriminel është edhe i akuzuari Čedomir Aksić
2. Nga Vërtetimi për djegien e shtëpisë së Sadri Jashari – lëshuar nga Kuvendi Komunal Shtime, nr. 06/350/7062, datë 19.03.2007, nga i cili vërtetohet se janë djegur shtëpitë e familjes Jashari.



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

3. Nga Fotoalbumi i shtëpive të djegura gjatë ofensivës së forcave serbe, po ashtu vërtetohet niveli i djegies se shtëpive të te dëmtuarve Jashari;
4. Nga Procesi mbi kryerjen e shikimit në vendngjarje – Kuvendi Komunal Shtime, nr. 07/1 datë 19.04.2002, vërtetohet se është bere zhvarrosja e viktimës Halil Hysenaj, me qellim të vërtetimit të shkakut të vdekjes,
5. Nga Letërnjoftimo i të akuzuarit Čedomir Aksić lëshuar nga Republika Federative Jugosllave, vërtetohen të dhënat personale të te akuzuarit Čedomir Aksić
6. nga fotoalbumi i vend varrezës se viktimës ku janë varrosur mbetjet mortore të viktimës Halil Hysenaj ref. EM. 02054/95749 datë 10.06.2021 vërtetohet vendi ku është bërë zhvarrosja dhe është siguruar prova materiale e cila ka qenë e vendosur në shishe të plastikës.
7. Nga Raporti policor post mortem i datës 10.06.2021 nga vendi i ngjarjes ku është bërë zhvarrosja vërtetohet se është siguruar prova materiale e cila ka qenë e vendosur në shishe të plastikës
8. Nga Letra e gjetur në varrin e Halil Hysenaj me tekst “Qeda e ka vrrarë Halilin”, vërtetohet se Čedomir Aksić e ka vrare të ndjerin Halil Hysenaj.
9. Nga Kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë e lidhur në mes të Abdullah Krasniqi dhe Čedomir Aksić, datë 30.10.2002, vërtetohet adresa e të akuzuarit Čedomir Aksić në Serbi
10. nga fotoalbumi i vend varrezës se viktimës ku janë varrosur mbetjet mortore të viktimës Halil Hysenaj ref. EM. 02054/95749 datë 10.06.2021 vërtetohet vendi ku është bërë zhvarrosja dhe është siguruar prova materiale e cila ka qenë e vendosur në shishe të plastikës.
11. Raporti i Policisë nga Policia i datës 17.08.2021 nga vendi i ngjarjes ku është bërë zhvarrosja dhe është siguruar prova materiale e cila ka qenë e vendosur në shishe të plastikës së bashku me fotoalbum si dhe
12. Nga Raporti i IML nr. TVD01-001B vërtetohet shkakut dhe rrethanat e vdekjes se Halil Hysenaj.

Ligji i aplikueshëm për rastin konkret;



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

Neni 3 i KPRK-së, i referohet situatës kur zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin dhe ka përcaktuar se (1) ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, (2) në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

Për të përcaktuar se cili është ligji më i favorshëm për të pandehurin në rastin konkret, prokurori i shtetit ka marrë bazë jurisprudencën e Gjykatës Supreme të Kosovës. Me aktgjykimin Pml.nr.138/2021 të datës 05.05.2021, në rastin e të dënuarit Darko Tasiç, Gjykata Supreme, ka konstatuar se, citoj: "... për të gjitha veprat penale të krimeve të luftës dhe për veprat e tjera të cilat janë kryer deri me datë 27 tetor 2020, e për të cilat është i zbatueshëm Ligji Penal i Jugosllavisë,...".

Andaj, prokurori i shtetit ka vendosur që të pandehurin ta akuzoj për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile, e ndëshkuar me nenin 142 të Ligjit Penal të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tutje "RSFJ") si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht i ndëshkueshëm sipas veprës penale Krime lufte në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët për konventat e Gjenevës, dhe nenin 4 të Protokollit 2 të datës 08.06.1977, aktualisht e ndëshkueshme me neni 146 dhe 147 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje "KPRK" në nenin 142 të LP i RSFJ).

Neni 142 i LP i RSFJ, ka përcaktuar në mori elementesh të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale të krime lufte kundër popullsisë civile.

Në kontekstin e subjektit që mund të jetë kryes i kësaj vepre penale, dispozita e këtij neni fillon me formulimin " Kush duke shkelur....". Kjo nënkupton se kryes i kësaj vepre penale mund të jetë cildo person fizik. Prokurori i shtetit vlerëson se, duke marrë parasysh natyrën e veprës penale të krimeve të luftës, ligjdhënësi ka përcaktuar se nuk është patjetër që kryesi të jetë pjesëtarë i ndonjë formacioni ushtarak, paraushtarak apo ndonjë formacioni tjetër. Këtë qëndrim juridik e ka dhënë edhe Gjykata Supreme e Kosovës në rastin me numër Pml.nr.351/219 të datës 26.12.2019.

Tutje, si element i veprës penale nga neni 142, parashihet edhe shkelja e rregullave të së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, të konfliktit të armatosur apo okupacionit. Në rastin konkret, praktika gjyqësore e Gjykatës Ndërkombëtare për ish- Jugosllavi dhe e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka vërtetuar faktin se në periudhën kohore 1998 deri në Mars 1999, ka pasur konflikt të armatosur kurse nga 24 mars 1999 deri me 11 qershor 1999 ka pasur luftë në kuptimin juridik të kësaj shprehje.

Prandaj, gjatë tërë periudhës kohore relevante për këtë aktakuzë, në zbatim ishin rregullat e së drejtës ndërkombëtare të përcaktuar në katër (4) Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe protokollet e saj. Protokollit -II- i vitit 1977, përcakton rregullat e të drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e civilëve në konflikte të armatosura Jo-ndërkombëtare ashtu që në nenin 4 paragrafi 2, shprehimisht ndalon - shkronja (a) dhuna ndaj jetës,



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mendore të njerëzve, në veçanti vrasja dhe trajtimi mizor, siç janë torturat, frikësimi ose ndonjë formë e ndëshkimit trupor;

(1) Personat që nuk janë të përfshirë direkt në armiqësi, përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe personat e paaftë për të luftuar për shkak të një sëmundje, plagë, privim të lirisë, ose për ndonjë arsye tjetër, do të trajtohen në çdo mundësi në mënyrë njerëzore, pa ndonjë dallim të pafavorshëm bazuar në racën, ngjyrën, fenë ose bindjen, gjininë, lindjen ose pronën, ose ndonjë standard tjetër të ngjashëm. Për këtë qëllim, për personat e lartpërmendur, janë të ndaluara dhe ndalohen në çdo kohë dhe në çdo vend veprimet e mëposhtme:

- a) plagosje për jetën dhe integritetin trupor, në veçanti të gjitha format e vrasjeve, gjymtimit, mizorisë dhe torturës;
- b) marrja e pengjeve;
- c) shkelja e dinjitetit personal, në veçanti trajtimi fyes dhe poshtërues;
- d) shqiptimi dhe ekzekutimi i dënimeve pa gjykim të mëparshëm nga një gjykatë e rregullt, shoqëruar nga çdo garanci gjyqësore e njohur nga popujt e civilizuar si të domosdoshme.

Këto rregulla, të cilat ishin të ratifikuara nga ish- Jugosllavia, kanë përcaktuar masa mbrojtëse për popullsinë civile në kohë konflikti dhe lufte, shkelja e të cilave përbën element të ndonjërisë nga veprat penale kundër njerëzimit dhe të së drejtës ndërkombëtare të përcaktuara në Kapitullin XVI, nenet 141 -156, të LP të RSFJ-së.

Dispozita e nenit 142 të KP të RSFJ në pjesën relevante përcakton me sa vijon:

kushdo që duke shkelur rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit, urdhëron që popullata civile të jenë subjekt i [...] marrja peng e njerëzve, [...] apo që kryen një nga aktet e përmendura [...].

Prokurori i shtetit vlerëson se ky nen ka paraparë dy (2) mënyra të kryerjes. Kushti i parë i referohet rasteve kur dikush urdhëron kryerjen e një vepre dhe kushti i dytë është kur dikush e kryen atë. Në rastin konkret, i pandehuri e ka kryer njëherë nga veprat penale të listuara në nenin 142. Hetimi vërtetoi se i pandehuri e ka kryer veprën penale dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mendore të njerëzve, në veçanti vrasja dhe trajtimi mizor, siç janë torturat, frikësimi ose ndonjë formë e ndëshkimit trupor, që është njëra nga veprat e listuara në nenin 142 të cekur më lartë. Provat që dëshmojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale janë deklaratat e dëshmitareve që edhe me pare e kanë njohur të akuzuarin Aksiq dhe të njëjtin e kanë identifikuar si kryes i veprave penale të krimeve të luftës.

Tutje, në lidhje me figurën e veprës penale nga neni 142 të LP- RSFJ-së, jurisprudenca vendore dhe ndërkombëtare ka zhvilluar një interpretim të gjerë dhe të detajuar. Në këtë aspekt Gjykata e Apelit me aktgjykimin numër PAKR.nr. 1121/12 të



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

datë 25 shtator 2018, i vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML nr. 125/2014 të datës 8 korrik 2014, ka përcaktuar standardin ligjor që e përbën figurën e veprës penale nga nenin 142 të LP të RSFJ-së. Gjykata thekson se, citoj : “

Me qëllim të përcaktimit nëse veprimet e të akuzuarit përbëjnë një krim lufte, duhet të adresohen këto elemente:

- a) a ka qenë duke u zhvilluar ndonjë konflikt i armatosur në Kosovë më ose rreth datës.....
- b) cilat kanë qenë normat e zbatueshme të cilat e kanë sunduar konfliktin e atëhershëm të vazhdueshëm të armatosur,
- c) a ka qenë konflikti i armatosur i natyrës ndërkombëtare apo jo ndërkombëtare,
- d) a ishin viktimat persona të mbrojtur nën ligjin ndërkombëtar, -
- e) a ka pasur lidhshmëri në mes të konfliktit të armatosur dhe veprës penale

Prokurori i shtetit konsideron se në rastin konkret, të gjitha provat materiale dëshmojnë se elementet e figurës së veprës penale të cekur më lartë, janë përmbushur sepse:

- lidhur me faktin nëse kishte një konflikt të armatosur në periudhën kohore objekt i kësaj aktakuze, prokurori i shtetit vlerëson se nuk ka dyshim se në atë kohë ka ekzistuar një konflikt i armatosur në Kosovë në periudhën kohore 1998 - qershor 1999. Kjo është vërtetuar nga jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare Kundër Jugosllavisë në rastin Milutinović etj. Për më tepër, sa i përket rastit konkret, provat e siguruar gjatë hetimit dëshmojnë se në periudhën kohore në janar të vitit 1999 është kryer edhe masakra e Reçakut. Faktin se në atë kohe kishte konflikt e vërtetuan të gjitha dëshmitë e dëshmitareve.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin numër Pml nr. 157/2014 të datës 2 tetor 2014, vërteton se, sipas nenit 3 paragrafi 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut me numër 2006/60 të datës 16 tetor 2006, konflikti i armatosur kishte ndodhur në periudhën kohore 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Prandaj, nuk është kontestues fakti se kishte konflikt të armatosur në atë periudhë kohore objekt i këtij shqyrtimi penal.

Po ashtu lidhur me normat e zbatueshme, vlerësojmë se tashmë jurisprudenca e GJNKJ dhe e GJS të Kosovës e kanë vërtetuar faktin se në raste të tilla, ishte i zbatueshëm Ligji Penal i RSFJ-së dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare. Me aktgjykimin numër Pml nr. 138/2021 të datës 05.05.2021, Gjykata Supreme, ka konstatuar se ligj i zbatueshëm është Ligji Penal i Jugosllavisë.

Ndërsa, lidhur me natyrën e konfliktit, prokurori i shtetit vlerëson se jurisprudenca e Gjykatës ndërkombëtare kundër Jugosllavisë në rastin Milutinovic etj., Sreten Lukic etj dhe Jurisprudenca Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin Selim Krasniqi etj, Latif Gashi etj., tashmë e kanë vërtetuar faktin se në territorin e Kosovës, duke filluar nga/ose rreth muajit Shkurt të Vitit 1998 deri me datën 24 mars 1999, ka



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

pasur konflikt të armatosur të karakterit jo-ndërkombëtarë, në mes të pjesëtareve të UÇK-së dhe forcave ushtarake dhe policore të RSFJ-së dhe Serbisë, kurse nga data 24 mars 1999 deri me 20 qershor 1999 ka pasur konflikt të armatosur të karakterit ndërkombëtar për shkak të përfshirjes së forcave të NATO-së në konflikt.

Si dhe lidhur me faktin nëse të dëmtuarit e këtij rasti, gëzonin mbrojtje nga ligji ndërkombëtar, prokurori i shtetit vlerëson se ky fakt vërtetohet nga të gjitha provat materiale në shkresat e lëndës. Viktimat ishin civil të pa armatosur dhe ishin dëbuar dhunshëm nga shtëpitë e tyre, janë vrare duke u përpjekur të largohen nga sulmet të cilat kishin filluar në atë zone. Po ashtu vërtetohet pa mëdyshje fare se shumica se në mesin e të vjetër kishte persona të shtyre në moshë dhe po ashti ishte edhe Hanumshahja e cila ishte e dobët me shëndet dhe kishte vetëm 16 vite jete.

Prokurori i Shtetit vlerëson se duke interpretuar nenin 3 të Konventës, kategoria e personave që gëzojnë mbrojtje nga konventa, janë ata persona të cilët nuk marrin pjesë në konflikt. Kjo kategori e personave zakonisht janë popullsia civile të cilët në parim nuk marrin pjesë fare në një aktivitet konflikti. Kështu që, kjo kategori e personave-civilët, gëzojnë mbrojtje që ofron neni 3 i Konventës, në rastin konkret, të dëmtuara - viktimat ishin popullsia civile.

Prokurori i shtetit vlerëson se standardi ligjor i cekur më lartë, i vendosur nga jurisprudenca e Gjykatave të Kosovës, përkitazi me faktin nëse vepra penale përbën krim lufte, në rastin konkret plotësohet. Është fakt i pa kontestueshëm se i pandehuri ishte i vetëdijshëm se veprimet e tij ishin pjesë dhe kontribuuan në kryerjen e krimeve kundër popullsisë civile nga forcat Serbe kundër popullsisë jo-serbe në Komunën e Shtimes. Dëshmitarët tregojnë se në atë kohë, në atë vend familjet shqiptare kishin filluar të largohen dhe gjate largimit nga shtëpitë e tyre janë zënë dhe janë vrare rrugës ose janë vrarë në shtëpitë e tyre.

Fakti që kishte një dhunë sistematike dhe të shpërndarë të forcave serbe dëshmon aktgjykimi Gjykatës Ndërkombëtare Kundër Jugosllavisë në rastin Milutinović etj.

Në bazë të asaj që u tha më lart, prokurori i shtetit vlerëson se të gjitha elementet subjektive të kryesit në raport me veprën penale të kryer, janë vërtetuar, duke përfshirë dashjen, dijeninë dhe qëllimin e tij në raport me veprën e kryer.

Prokurori i shtetit ka shqyrtuar të gjitha provat materiale relevante juridike, të siguruara gjatë hetimit dhe ka ardhur në përfundimin se vepra penale objekt i kësaj aktakuze është kryer dhe se i pandehuri subjekt i kësaj aktakuze, është kryes i saj. Kjo dëshmohet nga deklaratat e dëshmitarëve, nga raportet policore dhe nga provat tjera materiale.

Andaj, pas vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dëshmive të dëshmitarëve, provave materiale dhe ndërmarrjes se veprimeve hetimore u vërtetua



Numri i lëndës: 2020:0005587
Datë: 02.05.2023
Numri i dokumentit: 02476388

se në veprimet e të akuzuarit pa mëdyshje janë manifestuar elementet e veprës penale të sipërcituara, prandaj me të drejtë konstatoj se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivin e kësaj aktakuze.

Mbi këtë bazë konsideroj se aktakuza është e arsyeshme dhe e bazuar në ligj.

Prokurori i shtetit

Habibe Salihi

<https://ihldatabases.icrc.org/applic/ihl/ihl.nsf/1a13044f3bbb5b8ec12563fb0066f226/5cbb47a6753a2b77c12563cd0043a10b>

Prokurori v. Milan Milutinović, GJNKJ, aktgjykimi, 26 shkurt.2009, vëllimi 1 i aktgjykimit, paragrafët 840-881; prokurori v. Vlastimir Đorđević, GJNKJ, aktgjykimi, 23 shkurt 2011 para. 1579. <https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/en/jud090226-e1of4.pdf>

Prokurori v. Milan Milutinović, GJNKJ, aktgjykimi, 26 shkurt.2009, vëllimi 1 i aktgjykimit, paragrafët 915; <https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/en/jud090226-e1of4.pdf>